



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 135 AKTI

NR. 76 VENDIMI

Tiranë, më 12.11.2018

#### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, më datë 09.11.2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Arta G. Vorpsi**, këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “ligji nr. 84/2016”);

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen duke u bazuar në të tri kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Vorpsi, ushtron detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Ajo i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.05.2018 në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.05.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, zoti Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin znj. Arta Vorpsi.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)** në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 8.1.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. (\*\*\*) prot., datë 4.4.2018, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. (\*\*\*), datë 09.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Vorpsi.*

**Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. (\*\*\*) prot., datë 08.10.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 29.10.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 30.10.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 05.11.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 06.11.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 09.11.2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Arta Vorpsi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në Deklaratën e Pasurisë-Vetting, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, **subjekti deklaron këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme):

**1. Apartament banimi**, me sipërfaqe 116 m<sup>2</sup>, në rrugën “(\*\*\*)”, pallati nr. (\*\*\*), ap. (\*\*\*) në Tiranë, në pronësi të z. E. V. Zotërimi 0%, 100% në pronësi të bashkëshortit E. V. Blerë sipas kontratës së shitjes nr. (\*\*\*) rep, nr. (\*\*\*) kol, datë 14.3.2003. Çmimi i blerjes 2,000, 000 lekë.

**Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës VETTING:** Shitja e një pasurie të paluajtshme, tokë arë, në pronësi të z. Xh.V. (babi i z. E. V.), z. R. V. dhe znj. L. D.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë nr. (\*\*\*) datë 14.3.2003, për pasurinë e llojit apartament me sip. 116 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie (\*\*\*), me palë blerëse E. V., me vlerën 2,000 000 lekë, shumë e likuaduar;
- Vërtetim për përditësim karteles pasurie nr. (\*\*\*) rep., dt. 23.9.2016;
- Kartela e pasurisë për pasurinë apartament me sip. 128 m<sup>2</sup>;
- Harta treguese e regjistrimit të apartamentit;
- Kontrata shitje pasurie e paluajtshme nr. (\*\*\*), dt.13.3.2003 për pasurinë tokë arë me sip. 512 m<sup>2</sup>, shitës: Xh., F. dhe E. V., në shumën 2.000.000 lekë;
- Akt pjesëtimi vullnetar nr. (\*\*\*), dt. 26.11.2002 për pasurinë me sip. 3.436 m<sup>2</sup> në pronësi të Xh., R. V. dhe L. V. (D.). Xh. V. merr në pronësi pasurinë me sip. 512 m<sup>2</sup>, sip. 860 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e mbetur ngelet në bashkëpronësi.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 27.12.2001, për pasurinë me sip. 3.436 m<sup>2</sup>, në pronësi të Xh., R. dhe L. V.
- Kartela e pasurisë për pasurinë me sip. 3.436 m<sup>2</sup>, në pronësi të Xh., R. dhe L. V.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni:**

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 4.6.2018, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 6.7.2018, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë informon Komisionin se nga verifikimi rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit znj. A. G. V. nuk figurojnë pasuri. Nëpërmjet kësaj shkrese informohemi se z. E. Xh. V., (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) ka në pronësi pasurinë me përshkrimin: Apartament, me sipërfaqe 128 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “(\*\*\*)” me nr.pasurie (\*\*\*), volum 8, faqe 32, ZK (\*\*\*)

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 9.7.2018 drejtuar noterës M. Sh.

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.7.2018, noterë M. Sh. i vë në dispozicion Komisionit kontratën e shitjes nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 14.3.2003 me palë shitëse K. B., T. B. dhe T. B. (B.), palë blerëse E. V. Shuma e blerjes 2.000.000 lekë.

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 9.8.2018 noterës M. Sh.

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 22.08.2018, noterja vë në dispozicion të Komisionit kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. (\*\*\*) rep., nr (\*\*\*) kol., dt.13.3.2003 noterë M. Sh., për pasurinë tokë arë me sip. 512 m<sup>2</sup>, shitës: Xh., F. dhe E. V., në shumën 2.000.000 lekë.

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 9.7.2018 drejtuar noterës M. J.

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 13.7.2018 notere M. J. vë në dispozicion kontratë premtim shitje nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 30.10.2015, me palë shitëse/premtuese: Xh. V. (i ati i z. E. V.), R. V. dhe L.V. (D.) dhe palë blerëse J. J. Çmimi i shitjes së apartamentit 8.100.000 (tetë milion e njëqind mijë) lekë.

Kësti i parë 7.400.000 lekë do të paguhej nga BKT me nr. Llogarie (\*\*\*) nga një kredi që do të merrte në Alpha Bank blerësi J. J.

Kësti i dytë 700.000 lekë.

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 4.6.2018 drejtuar shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a.

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 20.6.2018 informon se shtetasi E. V. ka lidhur me UKT kontratën nr. (\*\*\*) për objektin me adresën në rrugën “(\*\*\*)”, Tiranë, ndërsa për shtetasen Arta Vorpsi nuk rezultojnë kontrata të lidhura.

- Shkresë nr(\*\*\*)prot., datë 4.6.2018 drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE.

Me shkresën nr. (\*\*\*)prot., datë 18.6.2018 OSHEE ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin, i cili vërteton se subjekti i rivlerësimit nuk është abonent, ndërsa me shtetasin E. V. rezulton të jetë lidhur kontrata (\*\*\*) për objektin apartament, ndodhur në rrugën “(\*\*\*)”.

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 4.6.2018 drejtuar ALUIZNI-t.

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 14.6.2018 ALUIZNI ka kthyer përgjigje negative se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

- Shkresë nr. (\*\*\*) Prot., datë 04.06.2018 drejtuar zyrës së regjistrimit noterial të Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë ka kthyer përgjigje në datë 21.6.2018 me nr. (\*\*\*) prot. *nga ku rezultojnë disa veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.*

### **Arsyetimi ligjor**

Apartamenti i banimit në rrugën “(\*\*\*)”, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, është blerë me kontratë nr. (\*\*\*) datë 14.03.2003. Çmimi i blerjes në këtë kontratë është përcaktuar 2,000,000 lekë për sipërfaqen 116 m<sup>2</sup>. Ky apartament është blerë nga K. B., T. B. dhe T. B., të cilët e kishin përfituar nga privatizimi në shumën 50329 lekë. Për këtë shitblerje është paguar tatimi përkatës, bazuar në mandatarkëtimin nr. (\*\*\*), datë 17.03.2003, në shumën 10,000 lekë.

Në deklaratën fillestare të vitit 2003 çmimi i këtij apartamenti është deklaruar 6,000,000 lekë nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me burim të ardhura nga prindërit.

Duke qenë se në të gjithë dokumentet, përfshirë edhe Deklaratën Vetting, rezulton si vlerë e blerjes së këtij apartamenti shuma prej 2,000,000 lekë, u pyet subjekti në lidhje me deklarimin e bërë në

vitin 2003. Më datë 14.09.2018, subjekti sqaron se ky apartament është blerë nga ana e bashkëshortit përpara martesës së tyre në vlerën e parashikuar në kontratën e shitblerjes. Për sa i përket deklaramit në vitin 2003, subjekti e konsideron një gabim njerëzor.

Duke qenë se në kohën që është kryer veprimi juridik i shitblerjes, nuk ekzistonte detyrimi ligjor për transferta nëpërmjet bankës të shumës së paguar për apartamentin, si dhe subjekti nuk kishte lidhur ende martesë me blerësin, nuk mund të vërtetohet me dokumentacion lëvrimit i shumës prej 2, 000, 000 lekë, por për këtë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti.

Si burim për blerjen e këtij apartamenti është përdorur shuma e dhuruar nga prindërit e zotit E. V.: Xh. dhe F. V. Për shkak të marrëdhënies prindër-fëmijë, nuk ka një dokument shkresor për dhurimin e kësaj shume.

Zoti Xh. V. i ka përfutuar këto të ardhura nga shitja e tokës arë me sipërfaqe 512 m<sup>2</sup>, në pronësi të tij. Këtë pronësi, z. Xh. V. e ka përfutuar nga trashëgimia e nënës së tij, zonjës H. V., bazuar në akt pjesëtimi vullnetar nr. (\*\*\*), dt.26.11.2002 për pasurinë me sip. 3.436 m<sup>2</sup> në pronësi të Xh., R. V. dhe L. V. (D.). Ndërsa zonja H. V. e ka përfutuar pronësinë bazuar në AMPT lëshuar nga fshati Selitë e Vogël.

Në kontratën e shitjes për pasurinë tokë arë me sip. 512 m<sup>2</sup> me nr. (\*\*\*), dt.13.3.2003 kanë nënshkruar përpara noterit, përveç Xh. V., në emër të të cilit figuronte prona, edhe bashkëshortja e tij, F., dhe djali E. Subjekti sqaron se nënshkrimi i dy anëtarëve të tjerë të familjes është kërkuar nga noteri, pavarësisht se nuk ishte detyrim ligjor. Nënshkrimi i tyre kishte për qëllim dhënien e pëlqimit për veprimin juridik.

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a, me shkresën nr. (\*\*\*), datë 20.6.2018 informon se shtetasi E. V. ka lidhur me UKT kontratën nr. (\*\*\*), për objektin me adresën në rrugën “(\*\*\*), Tiranë, ndërsa për shtetasen Arta Vorpsi nuk rezultojnë kontrata të lidhura.

Me shkresën nr(\*\*\*), datë 18.6.2018 OSHEE ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin, i cili vërteton se subjekti i rivlerësimit nuk është abonent, ndërsa me shtetasin E. V. rezulton të jetë lidhur kontrata (\*\*\*), për objektin apartament, ndodhur në rrugën “(\*\*\*).”

- ✓ Në përfundim, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë në Deklaratën Vetting, deklarim ky që përputhet me të dhënat e administruara nga hetimi administrativ. Pasaktësia në deklaramin për herë të parë në vitin 2003 e vlerës së apartamentit, kur subjekti nuk ka qenë në funksion (këshilltare ligjore), nuk vlerësohet se cenon besueshmërinë në deklaramin e subjektit.

2. **Automjet i tipit Ford Focus**, viti i prodhimit 2004, blerë në vitin 2010 në Gjermani, në shumën 2600 euro, me leje qarkullimi nr. (\*\*\*), në emër të Arta Vorpsit.

**Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës VETTING:** Shuma për blerjen e ka burimin nga shitja e automjetit të mëparshëm në pronësi (Ford Fiesta vit prodhimi 1996) në shumën prej 3.200 Euro. Zotërimi 100%.

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje, dt. 7.7.2010 për mjetin tip Ford Focus (2010), me numër shasje (\*\*\*) me targë (\*\*\*). Shitës “(\*\*\*)”, çmimi 2.600 Euro.
- Leje qarkullimi gjermane për mjetin Ford me numër shasje (\*\*\*), me targë (\*\*\*), vërtetim përkthimi nr. (\*\*\*) rep., dt 17.7.2010.
- Kontratë shitblerje nr. (\*\*\*), dt. 5.7.2010 për mjetin Ford Fiesta (viti 1996) me numër (\*\*\*), me targë (\*\*\*). Shuma 3.100 euro.

### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit**

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 4.6.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.

Me anë të shkresës nr(\*\*\*)prot., datë 12.6.2018 Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë informon Komisionin se, subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka në pronësi mjetin me targë (\*\*\*)(Ford Fokus vit prodhimi 2004) dhe ka pasur në pronësi mjetin me targë (\*\*\*) (Ford Fiesta vit prodhimi1996), ndërsa shtetasi E. V. nuk ka mjete të regjistruara në pronësi.

Nga dosja e mjetit rezulton se në datën 7.7.2010 është lidhur kontratë shitblerje me palë shitëse “(\*\*\*)”, për mjetin tip Ford Fokus me numër shasje (\*\*\*), me targë (\*\*\*). Çmimi 2.600 Euro. Automjeti është zhdoganuar dhe pajisur me targë (\*\*\*), në pronësi të znj. Arta Vorpsi.

Po nëpërmjet kësaj shkrese, Komisionit i është vënë në dispozicion edhe dosja e mjetit me targë (\*\*\*) (Ford Fiesta) në pronësi të subjektit të rivlerësimit, mjet i cili është tjetërsuar me kontratën nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol, datë 5.7.2010. Çmimi 3100 euro.

- Shkresë nr. (\*\*\*) rep., datë 9.7.2018 drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Me anë të shkresës nr. (\*\*\*)rep., datë 30.7.2018 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon Komisionin se, referuar të dhënave të raportuara nga shoqëritë e sigurimit në regjistrin elektronik të shitjeve, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti E. V. kanë përdorur mjetet me targë (\*\*\*) dhe (\*\*\*)).

### **Arsvetimi ligjor**

**A.** Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2010, me kontratën e shitjes me (\*\*\*), ka blerë mjetin Ford Focus, prodhim i viti 2004, për shumën 2600 Euro. Nga hetimi administrativ bazuar në shkresën e DPSHTRR-së rezulton se subjekti e ka zhdoganuar këtë mjet dhe më pas është pajisur me targë (\*\*\*). Sipas deklaratës doganore (\*\*\*), datë 17.07.2010, detyrimet doganore për këtë automjet kanë qenë 187.865 lekë. Në deklaratën e interesave private të vitit 2010 subjekti i rivlerësimit vlerën e këtij mjeti e ka deklaruar 3300 euro.

Subjekti është pyetur në lidhje me mospërputhjen midis çmimit të blerjes sipas kontratës dhe deklarimit në vitin 2010.

Për këtë subjekti sqaron se: *“Automjeti Ford Fokus është blerë për shumën 2600 Euro, siç është edhe kontrata e shitjes, e depozituar pranë agjensisë doganore. Arsyeja e deklarimit të shumës 3300 Euro ka qenë e llogaritur nga unë si shumë totale e shpenzimeve të kryera për blerjen e saj, pasi e konsiderova të nevojshme për ta llogaritur si shpenzim për qëllim të deklarimit të*



*shpenzimeve në deklaratën periodike. Në shumën 3300 Euro kam përfshirë shpenzimet për nxjerrjen e targave të përkohshme, siguracionin ndërkombëtar deri në zhdoganimin e automjetit, shpenzimet për kontrollin teknik (TUV), si dhe karburanti për të ardhur nga Gjermania në Shqipëri.”*

Ndërsa në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar saktësisht vlerën e mjetit sipas kontratës së shitjes.

Në lidhje me mjetin Ford Focus, subjekti i rivlerësimit ka përfshirë në deklarinimin për vitin 2010 edhe shpenzimet për zhdoganimin në vlerën 187.865 lekë të kryera në datën 17.07.2010. Ndërsa në Deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar çmimin e automjetit sipas kontratës së shitblerjes prej 2600 euro.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti kishte mundësi financiare për këtë blerje.

**B.** Si burim për blerjen e mjetit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e mjetit Ford Fiesta për shumën 3200 euro, ndërkohë, bazuar në kontratën nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*)kol., datë 05.07.2010 ky mjet është shitur për shumën 3100 Euro, por edhe në deklaratën e interesave private të vitit 2010 është deklaruar shuma 3100 euro. Për këtë diferencë prej 100 euro në deklarinim, subjekti pretendon se është lapsus nga ana e tij.

Ky mjet është blerë në datë 23.03.2007 për shumën 1200 euro dhe vlerë zhdoganimi 152,046 lekë. Blerja e këtij mjeti nuk është deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2007.

Pasi është pyetur për këtë fakt, subjekti është përgjigjur: *“Automjeti Ford Fiesta është blerë në 23.03.2007 në Gjermani dhe zhdoganimi është bërë në datë 02.04.2007. Besoj se duhet të jetë deklaruar në deklaratën e vitit 2008, pasi është regjistruar pas datës 31.03.2007, afati i fundit i deklarinimit të interesave pasurore periodike. Në dijeninë time e kam deklaruar në vitin 2008. Burim i të ardhurave ka qenë shuma e marrë nga shitja e automjetit BMW prej 200.000 lekë dhe pjesa tjetër nga kursimet e mia dhe të bashkëshortit nga të ardhurat vjetore.”*

Në deklaratën e interesave private të vitit 2003 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar automjet me vlerë 224,288 lekë blerë më 15.03.2002 me burim nga prindërit. Duke qenë se në asnjë nga deklaratat ndër vite të pasurisë, nuk figuron i shitur ky mjet, është pyetur subjekti lidhur me mosdeklarinimin në Deklaratën Vetting të mjetit, si dhe burimin e të ardhurave.

Subjekti, më datë 14.09.2018, ka sqaruar: *“Automjeti tip BMW prodhim i vitit 1990, është blerë në datë 30.12.2002, në Gjermani. Çmimi i blerjes ka qenë 1600 Euro, i konvertuar nga agjensia doganore në shumën 224.288 lekë. Automjeti është blerë nga bashkëshorti me të ardhurat nga puna e tij dhe kursimet familjare. Në atë kohë ai ka qenë i pamartuar dhe ka jetuar së bashku me prindërit. Bashkëshorti ka qenë me detyrë arsimtar dhe nuk ka pasur shpenzime të tjera, prandaj ka mundur që ai vetë dhe prindërit të kursejnë shumën me të cilën është blerë automjeti. Gjithashtu, për blerjen e tij janë përdorur edhe 200.000 lekë të përfituara nga shitja e automjetit që kishte në posedim tipi Ford Fiesta (prodhim i vitin 1987), i shitur në datë 14.10.2002. Automjeti është shitur nga bashkëshorti në datën 01.06.2007. Bashkëlidhur kontrata e shitjes. Çmimi i shitjes 200.000 lekë. Fakti i mosdeklarinimit është i papritur edhe për mua personalisht, kam qenë e bindur*

*që e kam deklaruar, pasi nuk kam pasur ndonjë arsye për të kundërtën. E konsideroj gabim njerëzor.”*

Për të vërtetuar deklaramet subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën doganore të datës 12.01.2003 për blerjen e automjetit tip BMW në shumën 1600 euro dhe detyrime doganore në shumën 224 288 lekë, Kontratën e shitjes nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 14.10.2002 për shitjen e mjetit tip Ford Fiesta (1987), si dhe Kontratën e shitjes së automjetit tip BMW me nr. (\*\*\*)rep., nr. (\*\*\*)kol., datë 01.06.2007.

- ✓ Komisioni konkludon se subjekti ka deklaruar me saktësi në Deklaratën Vetting të dhënat mbi këtë pasuri të luajtshme. Pavarësisht pasaktësive në deklaramet e viteve të mëparshme në lidhje me këto automjete, nuk rezultojnë të dhëna, që mund të dëmtojnë figurën e subjektit.

### **3. Deklarimi e të ardhurave.**

#### **Në Deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar:**

- Paga e deklaruesit Arta Vorpsi, si këshilltare e gjyqtarëve për periudhën 2005-2016, shuma 1.217.239.858 lekë;
- Paga e bashkëshortit E. V., si avokat shteti për periudhën prill 2013-shtator 2016, shuma prej 2.384.322 lekë;
- Shpërblimi si konsulente e jashtme e U., shuma 1.234.100 lekë.

#### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit**

- Shkresë nr. (\*\*\*) prot, datë 4.6.2018, dërguar bankave për informacion, në emër të Arta G.Vorpsi dhe E. Xh. V. për të cilën kanë kthyer përgjigje negative në total 21 institucione bankare.

#### **Gjendja e llogarive bankare rezulton:**

ProCredit Bank, me shkresën nr. (\*\*\*)prot. datë 20.6.2018, informon për llogari kursimi (data e hapjes 17.7.2017) dhe llogari rrjedhëse aktive (dt.7.4.2008) në emër të Arta Vorpsi.

#### **Për bashkëshortin E. V.:**

Kredi në shumën 200.000 lekë (e mbyllur);

Kredi në shumën 500.000 lekë (e mbyllur);

#### **Banka Kombëtare Tregtare (BKT), me shkresën (\*\*\*)prot, datë 21.6.2018 informon:**

Për Arta Vorpsi: llogaria 250,000 lekë (data e aprovimit 15.7.2008) statusi-i mbyllur;

Për E. V.: llogaria shuma prej 125,000 lekë (data e aprovimit 15.7.2008) (statusi- i mbyllur).

#### **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. (\*\*\*), datë 7.6.2018, informon:**

Për Arta Vorpsi:

Llogari page me gjendje 104,524 lekë;

Llogari me valutë për tërheqje master Card, gjendje 64.15 euro;

Llogari me valutë, me gjendje 16,415.81 Euro

Për E. V.:

Llogari page me gjendje 123,355 lekë

Ka qenë kredimarrës:

Kredi në shumën 700,000 lekë, e marrë në vitin 2006 dhe shlyer në vitin 2009;

Kredi në shumën 500,000 lekë, e marrë në vitin 2014 dhe shlyer në vitin 2016;

Overdraft në shumën 110,000 lekë, i cili është mbyllur në vitin 2014.

**Intesa San Paolo Bank me shkresën nr. (\*\*\*)datë 14.6.2018, informon:**

Për Arta Vorpsi:

Llogari rrjedhëse nga e cila në datën 1.4.2016, ka tërhequr shumën 840 Euro, ekuivalent me 116,529 lekë dhe në datën 30 prill 2018 shumën prej 2,550 Euro, equivalent me 271, 065.00 lekë.

Për E. V.:

Rezultojnë dy llogari rrjedhëse me datë mbarimi më 27.3.2018;

Llogaria në lekë me fond 10,079.00 lekë, e çelur më 26.7.2010, rezulton e mbyllur më 27.3.2010 -3552.41 lekë;

Llogaria në euro me gjendje fillestare 2.5 Euro, në datën 31.12.2012 rezulton me -29.11 euro

- Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 9.7.2018 Shkolla Shqiptare e Administratës Publike na vë në dispozicion informacionin për bashkëpunimin me subjektin e rivlerësimit gjatë viteve 2003-2013 dhe 2014-2018 si trajnere e jashtme. Shuma totale e paguar është 858, 500 lekë bruto;
- Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 24.7.2018 Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës informohemi se znj. Arta Vorpsi është angazhuar si pedagoge me kohë të pjesshme pranë këtij fakulteti, për vitet 2015-2017, shuma totale e paguar është 205, 000 (dyqind e pesë mijë) lekë bruto;
- Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 09.10.2018 Fakulteti i Drejtësisë, Kolegji Universitar “(\*\*\*)” informohemi se znj. Arta Vorpsi është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë këtij fakulteti, për periudhën janar 2009 - dhjetor 2013, shuma totale e paguar është 694,525 (gjatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë bruto;
- Me shkresën nr. (\*\*\*)prot., datë 16.7.2018, Shkolla e Magjistraturës na vë në dijeni se znj. Arta Vorpsi ka qenë aktivizuar si eksperte e trajnimit vazhdues dhe autore shkrimesh për periudhën 2010-2018, shuma e paguar 208.540 lekë bruto;

- Me shkresën nr. (\*\*\*)prot., datë 20.7.2018 shkolla e lartë jopublike “(\*\*\*)” informohemi se subjekti i rivlerësimit për veprimtarinë e mësimdhënies gjatë viteve 2009-2011 është paguar me shumën 136, 750 lekë neto;
- Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 02.10.2018 Universiteti (\*\*\*) informon se subjekti ka qenë e angazhuar në këtë universitet për periudhën 01.10.2009-30.06.2010, si dhe 01.03.2018-16.06.2018 dhe është paguar me shumën 10800 euro neto në total për periudhën e parë dhe 156 289 lekë për periudhën e dytë. Ajo është paguar gjithashtu edhe në shumën 762.3 euro për udhëheqje diplomash;
- Fondacioni “(\*\*\*)” konfirmon se në vitin 2012 subjektit të rivlerësimit i është paguar shuma prej 2,000 Euro për publikimin e librit “Parime Kushtetuese dhe e drejta themelore për jurisprudencën në Gjykatën Kushtetuese”;
- Fondacioni (\*\*\*) konfirmon ka i paguar shumën prej 1950 Euro neto në vitin 2015 subjektit të rivlerësimit, me cilësinë e ekspertes;
- Nëpërmjet shkresës nr. (\*\*\*)prot., datë 13.7.2018 nga Avokatura e Shtetit informohemi për të ardhurat e z. E. V. si avokat shteti, për vitet 2013-2017 në total 4.269.876 lekë (bruto) dhe 3.286.473 lekë (neto).
- Shkresë nr. (\*\*\*)prot., datë 28.6.2018, të dhënat nga sistemi c@ts i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, tregojnë se të ardhurat bruto apo paga, shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit të tatueshme për subjektin e rivlerësimit janë në shumën 1, 817, 301 lekë.

### **Arsyetimi ligjor:**

**A.** Nga shqyrtimi i Deklaratës Vetting dhe dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti ka deklaruar si të ardhura nga paga si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese shumën prej 1.217.239.858 lekë. Në vërtetimin e depozituar pranë ILDKPKI-së, shuma e pagave të subjektit për periudhën 16.09.2005-31.12.2016 është 14.630.653 lekë.

Në lidhje me këtë mospërputhje është pyetur subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit të datës 26.09.2018, sqaron se ky gabim ka ardhur si pasojë e përgatitjes së dy vërtetimeve nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Gjykatën Kushtetuese, njëri në tetor 2016, kur hyri në fuqi ligji nr. 84/2016 dhe filloi zbatimin e tij, i cili përfshinte pagën bruto shtator 2005-shtator 2016, pasi afati i fundit i dorëzimit të deklaratave ishte fillimisht tetori i vitit 2016. Ndërsa vërtetimi i dytë u përgatit me të ardhurat nga paga neto për periudhën shtator 2005-31 dhjetor 2016 dhe Deklarata Vetting u dorëzua në janar 2017, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që hiqte masën e pezullimit të ligjit nr. 84/2016.. Subjekti deklaroi se “...për saktësi duhet marrë për bazë vërtetimi bashkëngjitur Deklaratës Vetting, në shumën prej 14.630.653 lekë”.

**B.** Referuar deklaramit periodik të vitit 2016, subjekti ka deklaruar:

- gjendje në llogarinë rrjedhëse në lek, në Raiffeisen Bank në datë 30.12.2016 në vlerë 61.135,12 lekë;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse në euro në Raiffeisen Bank në datë 30.12.2016 në vlerë 6.000 euro.
- gjendje në llogarinë rrjedhëse në lek në ProCredit në datë 30.12.2016 në vlerë 178.301,82 lekë.

Në dokumentat e ILDKPKI-së subjekti ka paraqitur:

- vërtetim nga banka Raiffeisen llog.nr. (\*\*\*) në euro, shuma 6000.01 euro në datë 10.01.2017,
- statement bankar nga banka Raiffeisen llogaria nr. (\*\*\*) në lek në vlerë 6680.12 në datë 24.01.2017,
- statement bankar nga banka Raiffeisen llogaria nr. (\*\*\*) në lek në emër të bashkëshortit në vlerë 58.523.78 lekë në datë 23.01.2017,
- vërtetim nga Procredit bank datë 24.01.2017, për llogarinë rrjedhëse në lek në emër të subjektit, me vlerë 478.152,82 lekë.

Këto shuma nuk janë deklaruar më vete në deklaratën Vetting.

Subjekti, në përgjigjen e tij të datës 04.10.2018 ka sqaruar se duke qenë që shumat e mbetura në fund të vitit kanë qenë të vogla dhe duke qenë se ka deklaruar të ardhurat gjatë vitit, ka menduar se rrjedhimisht këto shuma kanë qenë të përfshira në deklaram.

**C.** Konstatohet se në Deklaratën Vetting janë deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortit për periudhën 2013-shtator 2016 në vlerën 2.384.322 lekë, por nuk janë deklaruar të ardhurat e bashkëshortit për periudhën përpara vitit 2013 si mësues, zv/drejtor shkolle 8-vjeçare (të deklaruara në deklaratimet periodike në shumën totale 1.672.000 lekë)

Referuar përgjigjeve të pyetësorit të datës 26.09.2018, subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e pagave të bashkëshortit për periudhën përpara vitit 2013 ka sqaruar se: *“...bashkëshorti im për periudhën 2003-2011 ka qenë me detyrë arsimtar dhe për disa vite zv/drejtor i shkollës 8-vjeçare, deri në shkëputjen e kësaj marrëdhënie pune në tetor të vitit 2011...bashkëlidhur vërtetimi i pagës i lëshuar nga Bashkia Vorë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë ...”*

Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 2003-2011, referuar këtyre vërtetimeve janë 3.181.425 lekë.

**D.** Janë deklaruar në Deklaratën Vetting të ardhura nga shpërblimet si konsulente e jashtme e (\*\*\*) në vlerë 1.234.100 lekë.

Është paraqitur një kontratë konsulence nr. (\*\*\*) e (\*\*\*), firmosur në datë 21.10.2015, me afat 21.10.2015-30.04.2016, në shumën 6000 USD, konvertuar në 749.700 lekë, e ndarë në dy tranxhe, deri në nëntor 2015 shuma 374.850 lekë dhe tranxhi 2 deri në prill 2016 në shumën 374.850 lekë, e amenduar deri në datë 30.06.2016 me një shtesë në vlerë 484.400 lekë. Shuma totale 1.234.100 lekë.

**E.** Nuk janë deklaruar në deklaratën Vetting të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia në Universitetet (\*\*\*), (\*\*\*), (\*\*\*), ASPA etj si dhe të ardhurat nga shërbimet konsulente për (\*\*\*),(\*\*\*),(\*\*\*), eksperte e komisionit të Reformës Kushtetuese nga (\*\*\*),(\*\*\*)etj. Shuma totale e të ardhurave nga shpërblimet dhe honoraret deklaruar në deklaratimet periodike vjetore ka qenë në vlerë 9.098.950 lekë, ndërsa në Deklaratën Vetting shuma e të ardhurave nga shpërblimet është deklaruar në vlerë 1.234.100 lekë (vetëm nga (\*\*\*))

Lidhur me mospërputhjet në deklarimin e të ardhurave në Deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“...këto të ardhura nuk janë deklaruar në Deklaratën Vetting, por vetëm në deklaratat periodike...duke qenë se këto të ardhura të fituara prej meje ndër vite nuk kanë*

*shërbyer për të krijuar pasuri të paluajtshme as të luajtshme, mendova se nuk është e nevojshme t'i deklaroj posaçërisht për procesin në kuadër të Vetting...”*

Subjekti i rivlerësimit, është deklarues pranë DRT Tiranë, për Deklarim Individual Vjetor të të Ardhurave DIVA (referuar shkresës nr (\*\*\*) prot, datë 26.06.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë), dhe ka deklaruar për vitet 2014 dhe 2017, konkretisht:

Periudha	Të ardhura paga bruto	Të ardhura të tjera	Tatim për t'u paguar
14-A	1817301	163234	0
17-A	1921720	4658201	675080

**F.** Nga analiza e treguesve financiare për periudhën 2004-2016 (duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e vërtetuara me dokument analitik ligjor dhe për të cilën janë shlyer detyrimet përkatëse tatimore mbi të ardhurat), rezultoi se subjekti bashkë me bashkëshortin ka rezultuar me balancë fondesh si më poshtë:

<b>Periudha</b>	<b>Balanca e Fondeve</b>
2005	372 833
2006	562 801
2007	1 081 703
2008	228 249
2009	1 399 109
2010	2 142 087
2011	950 696
2012	1 785 957
2013	- 468 959
2014	2 041 715
2015	1 405 250
2016	2 198 725

Subjekti rezultoi me mungesë të mjeteve financiare në vitin 2013.

Referuar të dhënave nga ProCredit Bank rezulton se bashkëshorti E.V. ka lidhur një kontratë kredie në datë 15.10.2012, në shumën 500.000 lekë me objekt për konsum, shuma është disbursuar në datë 15.10.2012, në të njëjtën datë është tërhequr vlera 497.000 lekë, gjithashtu bashkëshorti është kredituar nga kjo bankë në datë 01.02.2013 në shumën 200.000 lekë.

Këto kredi nuk janë deklaruar nga subjekti, në deklarin periodik të vitit 2012 dhe 2013, si detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë.

Duke iu referuar të ardhurave të vërtetuara për vitin 2013, pagesës së kredisë së mëparshme në Procredit (në emër të bashkëshortit në vlerë 500.000 lekë) llogaritjeve të përafërta të udhëtimeve

referuar hyrje daljeve nga sistemi TIMS, si dhe shpenzimeve për jetesë del me pamjaftueshmëri të ardhurash ky vit, konkretisht:

### Analiza financiare për vitin 2013

Të ardhurat nga paga dhe shpërblimet	1964139
<b>Total mjete monetare të hyra</b>	<b>1964139</b>
Shlyerje kredie nga viti 2012	500000
Interesa kredie	26300
Shpenzime mjekësore të deklaruara Austri	168252
Shpenzime bileta+qëndrim (TIMS)	1395090
Pagesat për shpenzime jetese	320000
<b>Total shpenzime</b>	<b>2409642</b>
Ndryshim mjetesh monetare gjendja 01.01.2013-31.12.2013	-23457
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-468960</b>
<b>Pagesa për blerje pasurie</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>0</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-468960</b>

Për të shpjeguar këtë situatë është pyetur subjekti më datë 16.10.2018.

Në shpjegimet e tij të dërguara më datë 18.10.2018, subjekti sqaron se :

*“...Në datë 29.03.2011, e ëma e bashkëshortit , F.V. ka hapur një depozitë me afat në shumën 2.000.000 lekë pranë bankës Pro Credit Bank. Veprimet bankare për këtë qëllim janë kryer nga bashkëshorti E. V. ...i cili ka pasur prej vitesh dhe ende ka prokurë të përgjithshme nga të dy prindërit e tij (F. dhe Xh. V.) për të kryer të gjitha veprimet juridike lidhur me ...hapjen administrimin (tërheqjen, depozitimin, etj) si dhe mbylljen e llogarive bankare...*

*...gjatë periudhës që shuma prej 2.000.000 lekë , ka qenë në depozitë kursimi, prindërit e bashkëshortit kishin nevojë për likuiditete, por ndërkohë nuk dëshironin të prishnin depozitën e kursimit. Kjo kredi në shumën 500.000 lekë do të kishte si kolateral depozitën e kursimit prej 2.000.000 lekë dhe shlyerja e saj do të bëhej automatikisht nga interesat e përfituara nga depozita me afat...*

*...arsyeja përse i është disbursuar E. V. dhe jo F. V., qëndron në faktin se ai kishte prokurë për këtë veprim...asnjë veprim lidhur me këtë llogari nuk është kryer nga F.V., për shkak se ajo është e pamundur fizikisht dhe e shkuar në moshë...*

*...duke qenë se edhe kolaterali për shumën 500.000 lekë edhe shlyerja e kësaj shume është bërë nëpërmjet llogarisë së depozitës...bashkëshorti im dhe unë nuk kemi përfituar dhe as shpenzuar për shlyerjen e kësaj kredie...”*

Për të vërtetuar deklarimin e tij, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentat bankare të ProCredit Bank, të cilat Komisioni i dispononte edhe nga përgjigjet e kësaj banke gjatë hetimit administrativ. Nisur nga deklarimi i subjekti, që shuma e kredisë në vlerë 500.000 lekë, sipas kontratës së kredisë në datë 15.10.2012, nuk ka pasur përfitues atë dhe bashkëshortin e saj, por nënën e tij, atëherë në deklarimin periodik të vitit 2012, kjo situatë do të duhej të sqarohet tek të dhëna konfidenciale ose mund të deklarohet edhe si detyrim ndaj bankës, njëkohësisht edhe si huadhënie ndaj nënës së bashkëshortit.

Ndërsa për vitin 2013, nga subjekti është bashkëlidhur një lëvizje nga ProCredit në të cilën përshkruhet transferata brenda bankës e datës 02.04.2013, ku në llogarinë në emër të E. V. në këtë bankë është transferuar shuma 726.300 lekë me përshkrim “Vorpsi F.R. kalim shume për mbyllje të kredive”.

Nisur nga këto të dhëna u rishikua situata financiare e subjektit për vitin 2012 dhe 2013, duke u eliminuar si shpenzim direkt shuma e kredisë së mbartur nga viti 2012 (500.000 lekë) dhe shuma e interesave në vlerë 26.300 lekë.

Balanca e fondeve pas shpjegimeve ndryshon për vitet 2012 dhe 2013 si më poshtë:

<b>Periudha</b>	<b>Balanca e Fondeve</b>
2005	372 833
2006	562 801
2007	1 081 703
2008	228 249
2009	1 399 109
2010	2 142 087
2011	950 696
2012	1 285 957
2013	57 340
2014	2 041 715
2015	1 405 250
2016	2 198 725

Në përfundim konkludohet se:

- Në Deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar të ardhurat në mënyrë të saktë, por pa referuar gjendjen e llogarive bankare.
- Subjekti nuk ka përfshirë në deklarim të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 2005-2011, si dhe detyrimet ndaj prindërve të tij për kredinë e shlyer. Këto të ardhura janë shpenzuar në vitet e mëparshme, ndërsa detyrimi ndaj prindërve i dedikohet marrëdhënies familjare mes tyre.



- Subjekti nuk ka përfshirë në Deklaratën Vetting të ardhurat e fituara ndër vite nga aktiviteti profesional, jashtë marrëdhënieve të punës në Gjykatën Kushtetuese, por ka qenë korrekt në deklarimin e tyre ndër vite. Këto të ardhura të fituara ndër vite janë përdorur për shpenzime familjare dhe jo për investime në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe se ato nuk i dispononte më në kohën e deklarimeve vetting.

## **Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit**

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka qenë e saktë në deklarimin e saj në Deklaratën Vetting.

Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklarimet ndër vite nuk kanë arritur nivel të mjaftueshëm për krijimin e dyshimeve dhe marrjen e masave të mëtejshme.

Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht pasaktësive në deklarime ndër vite të konstatuara, nuk ka pasur për qëllim të fshehtë apo paraqitje në mënyrë të pasaktë pasuritë apo të ardhurat. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Vorpsi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. (\*\*\*), datë 09.07.2018, për subjektin e rivlerësimit. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj.Arta Vorpsi.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. (\*\*\*)prot., datë 08.10.2018,

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

1. Formulari i vetëdeklarimit, te 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, që në rastin konkret mungojnë për shkak të detyrës që ka ushtruar subjekti i rivlerësimi.

Subjekti i rivlerësimit, këshilltarja ligjore Arta Vorpsi në datën 24.01.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet e mëposhtme:

- 1) Formulari i vetëdeklarimit, gjithsej 7 (shtatë) fletë;
- 2) 13 dokumente shoqëruese të Formularit të Vetëdeklarimit, gjithsej 284 (dyqind e tetëdhjetë e katër ) fletë;
- 3) Lista e dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, gjithsej 1 (një) fletë.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

- a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, me faqe të nënshkruara rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat për periudhën shkurt 2001 e deri aktualisht.

- b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën B të formularit, për periudhën shkurt 2001 deri shtator 2005, subjekti ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e drejtorit të studimeve dhe botimeve në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa për periudhën shtator të vitit 2005 e në vazhdim ka deklaruar se ushtron detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

- c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka deklaruar se tre vitet e fundit ka punuar në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtat e njeriut, e drejta civile, e drejta penale, e drejta administrative, e drejta evropiane dhe ajo ndërkombëtare, duke përcaktuar specializim me titullin “Doktor i shkencave juridike” në vitin 2001 në Universitetin e Vienës, e njohur kjo nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Subjekti i rivlerësimit në funksionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, ka deklaruar këto të dhëna:

- Në vitin 2014 i janë caktuar dhe ka përpunuar 33 kërkesa
- Në vitin 2015 i janë caktuar dhe ka përpunuar 32 kërkesa
- Në vitin 2016 i janë caktuar dhe ka përpunuar 38 kërkesa

Këto të dhëna të deklaruara, nuk dokumentohen me ndonjë shkresë nga Gjykata Kushtetuese.

#### ç) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka deklaruar se nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që trajnohen nga Shkolla e Magjistraturës, por trajnimet dhe pjesëmarrja në aktivitetet e tjera shkencore janë bërë mbi baza vullnetare ose në ato të organizuara nga Gjykata Kushtetuese.

Ajo ka deklaruar se ka qenë trajnere pranë Shkollës së Magjistraturës në programin vazhdues për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në seminarin me temë “*Zbatueshmëria e parimit kushtetues të së drejtës për të mos u gjykuar dy herë në këndvështrimin e KEDNJ-së*”, të zhvilluar në datat 15-16 qershor 2016, duke bashkëngjitur për këtë vërtetimin nr. (\*\*\*)prot, datë 21.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar se gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, ka marrë pjesë në 8 trajnime dhe aktivitete ndërkombëtare, por konstatohet se tre viteve të fundit i përkasin vetëm 4 prej tyre, me temë :

- i. Trajnim me temë “EU Gender Equality Law-Seminar for member of the Judiciary” në Trier, Gjermani, datë 9-10 mars 2015;
- ii. Pjesëmarrje në kongresin e XVI ndërkombëtar me temë “Civil Law and Constitution”, në Gjermani, në 17-18 tetor 2014;
- iii. Pjesëmarrje në kongresin e XVII ndërkombëtar me temë “Constitutional courts and ordinary courts - Cooperation or conflict”, në Gjermani, datë 16-17 tetor 2015;
- iv. Pjesëmarrje në Kongresin XIII ndërkombëtar me temë “Constitutional Justice and Politics”, në Gjermani datë 14-15 tetor 2016.

Këto të dhëna konfirmohen me fotokopje të ftesave, programeve dhe certifikatave të bashkëngjitura formularit.

#### d) Tri dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 relacione, të deklaruara si një i vitit 2013 dhe dy të tjerët të vitit 2016, për çështjet me nr. 11 vendimi, datë 05.04.2013; nr. 15 akti, datë 15.03.2016 dhe çështja me nr. 23 vendimi, datë 23.04.2016, të përpiluara prej saj, të cilat analizohen si më poshtë:

1. **Dokumenti 1.** Relacion i subjektit Arta Vorpsi i datës 16.07.2012, për çështjen që i përket kërkuesit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekte të interesuara Kuvendi i Shqipërisë e Këshilli i Ministrave, me objekt “shfuqizimin e nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile si i papajtuashëm me nenin 42/2 të Kushtetutës”.

**Kjo çështje konstatohet se është e relatuar jashtë periudhës së rivlerësimit.** Në këtë relacion, këshilltarja Arta Vorpsi ka sugjeruar kalimin e çështjes për gjykim pasi i plotëson kriteret formale për t’u kaluar në seancë dhe sepse gjykata (kërkuesi) ka dhënë argumente lidhur me antikushtetueshmërinë e nenit 75 të KPC. Në këtë mënyrë ajo ka krijuar bindjen se kjo dispozitë bie ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor, konkretisht me gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Relacioni është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja dhe dispozita ligjore objekt gjykimi; ii) pretendimet e gjykatës referuese lidhur me dispozitën konkrete procedurale, ku strukturohen në paragrafë shkaqet për të cilat neni 75 i K.Pr.Civile nuk jep garanci të mjaftueshme për paanshmëri në gjykim dhe garantim të një procesi të rregullt ligjor, pasi vetë gjyqtari duhet të gjykojë mbi njëanshmërinë e tij, kur kjo kërkohet nga palët në proces; iii) mendimi i këshilltarit për kalimin për gjykim, me analizën e çështjes që neni 75 i KPC duhet të vendosë mbi kërkesën e përsëritur të paditësit për të përjashtuar trupin gjykues. Relacioni në 2 faqe, mban datën 16.07.2012 por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe “Mendim për shfuqizimin e nenit 75 të K.Pr.Civile si antikushtetues”, i cili është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja e shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pezullimi i gjykimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese; ii) pretendimet e gjykatës referuese, lidhur me dispozitën konkrete procedurale, ku referohet për analogji edhe K.Pr. Penale; iii) Mbi bazueshmërinë e kërkesës, e ndarë kjo në katër elemente si: 1) Lidhja e drejtpërdrejtë e dispozitës me çështjen në shqyrtim, 2) Bindja e gjyqtarit mbi antikushtetueshmërinë e dispozitës, 3) Kushtetutshmëria e dispozitës dhe 4) Përfundime, se dispozita e nenit 75 të K.Pr.Civile bie ndesh me parimin e gjykatës së paanshme, si element i procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar në fund se kërkesa e gjykatës referuese duhet pranuar si e bazuar. Mendimi në 8 faqe mban datën 04.10.2012, por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Nga vendimi nr.11, datë 11.10.2012, që i përket çështjes objekt relatiimi të subjektit, rezulton se **Gjykata Kushtetuese ka vendosur sipas mendimit të subjektit Arta Vorpsi**, duke shpallur :

“Pranimin e kërkesës.

Shfuqizimin si të papajtuashëm me nenin 42/2 të Kushtetutës të fjalisë së parë të nenit 75 të K.Pr.Civile me këtë përmbajtje: *“Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen”*.

Paragrafët, si në relacion, ashtu edhe në mendim, janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të relacionit

janë përdorur referenca në faqen 7 të tij, konkretisht në Kodin e Procedurës Civile gjerman, austriak dhe italian.

2. **Dokumenti 2.** Relacion i subjektit Arta Vorpsi i datës 16.05.2015 për çështjen që i përket kërkuessit: Komanda e Forcave Ajrore, Reparti ushtarak nr. 3001, Rinas, Tiranë, subjekte të interesuar Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave e Ministria e Financave, me objekt “shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të vendimeve nr.1797, datë 03.06.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nr. 1650, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, etj”.

Në relacionin drejtuar Kolegjit të Gjyqtarëve, këshilltarja Arta Vorpsi ka sugjeruar që pretendimet e kërkuessit duhet të sqarohen dhe shqyrtohen në seancë gjyqësore, pasi shfaqin probleme të mosrespektimit të së drejtës kushtetuese për t’iu drejtuar gjykatës.

Relacioni është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja, për kontratën e lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shoqërisë “(\*\*\*)”, aktet administrative dhe vendimet gjyqësore objekt gjykimi; ii) pretendimet e kërkuessit lidhur me vendimet gjyqësore administrative të Gjykatës së Lartë dhe asaj të Shkallës së Parë Tiranë, për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes; iii) mendimi i këshilltarit për kalimin e çështjes për gjykim, duke analizuar mbi legjitimitimin e kërkuessit në kuptimin formal, në kuptimin material, mbi juridiksionin e gjykatës dhe mbi bazueshmërinë e pretendimeve. Relacioni në 6 faqe, mban datën 16.03.2015, por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe aktin “Mbi legjitimitimin e individit para Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me çështjen me kërkuess Komanda e Forcave Ajrore”, ku ka renditur dispozitat ligjore lidhur me kriteret e legjitimitimit të individit, ato të parashikuara në Kushtetutë, ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencë të kësaj gjykate lidhur me këto kritere.

Po kështu, ky subjekt ka paraqitur bashkëngjitur relacionit edhe “Mendim mbi kërkesën e Komandës së Forcave Ajrore”, i cili është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja për kontratën e lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shoqërisë “(\*\*\*)”, aktet administrative të nxjerra nga Kuvendi i Shqipërisë dhe institucionet si Dega e Doganës Rinas, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Komanda e Forcës Ajrore, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë; ii) pretendimet e kërkuessit lidhur me cenimin e të drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor, sepse është cenuar parimi i arsytimit të vendimit gjyqësor, duke sjellë cenimin e të drejtës së tyre për akses në gjykatë, duke argumentuar si të vetmen mënyrë për të riparuar të drejtën që bashkë me shfuqizimin e vendimeve, të nisë edhe një kontroll kushtetutshmërie i nenit 289/3 i Kodit Doganor; iii) Mbi kalimin e kërkesës për gjykim, subjekti ka parashtruar legjitimitimin e kërkuessit si një subjekt i të drejtës publike, juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, të parashikuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, si mjet për të kundërshtuar një ligj antikushtetues; iv) Mbi bazueshmërinë e pretendimeve, duke analizuar si të cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe duke parashtruar rolin e kontrollit konkret nga gjykatat, subjekti ka dalë në konkluzionin se vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ai i kolegjit administrativ, duke mos i dhënë përgjigje kërtimeve të kërkuessit, nuk kanë përmbushur standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Si përfundim ,subjekti ka dhënë dy mënyra vendimmarrjeje: 1)

për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave dhe kthimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë; dhe 2) për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave dhe shqyrtimin e kushtetueshmërisë të nenit 289/3 të Kodit Doganor. Mendimi në 22 faqe i subjektit mban datën 08.05.2015, por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Nga vendimi nr. 23, datë 16.11.2015, që i përket çështjes objekt relativity të subjektit, rezulton se **Gjykata Kushtetuese ka vendosur sipas mendimit të parë të subjektit Arta Vorpsi**, duke shpallur :

*“Pranimin e pjesërisht të kërkesës.*

*Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1650, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1797, datë 03.06.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*

*Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera”.*

Paragrafët, si në relacion ashtu edhe në mendim, janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të mendimit janë përdorur referenca në fund të faqes 10, 13, 14, 16, 17 dhe 21 të tij.

3. **Dokumenti 3.** Relacione te subjektit Arta Vorpsi për çështjen që u përket kërkuësve: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Avokati i Popullit, Partia Republikane Shqiptare, Shoqata e pronarëve legjitimë “(\*\*\*”, Shoqata “(\*\*\*”, Shoqata “(\*\*\*)” dhe Shoqata kombëtare “(\*\*\*”, subjekte të interesuar: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave e Agjencia e Trajtimit të Pronave, me objekt: “shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 dhe pezullimin e tij”.

Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 4 relacione. Relacioni i parë, që i përket kërkuësit Presidenti i Republikës, është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë ligji që kërkohet të shfuqizohet, dekreti i Presidentit të Republikës lidhur me këtë ligj dhe vendimi i Kuvendit të Shqipërisë lidhur me këtë dekret; ii) pretendimet e kërkuësit dhe shkaqet që ka parashtruar, ku pretendimi thelbësor është se ligji cenon parimin e sigurisë juridike; iii) analiza e çështjes, lidhur me 1) legjitimitimin e kërkuësit, 2) bazueshmërinë *prima facie* të pretendimeve, cenimin e të drejtës së pronës, të sigurisë juridike, të së drejtës së ankimit dhe pezullimit të zbatimit të ligjit. Në përfundim të relacionit është parashtruar mendimi i këshilltarit për kalimin e çështjes në seancë plenare dhe pranimin e kërkesës për pezullimin e ligjit objekt kërkesë. Relacioni në 13 faqe, nuk përmban datë dhe nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Relacioni i dytë, që i përket kërkuësit 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë ligji që kërkohet të shfuqizohet dhe objekti i tij; ii) pretendimet e kërkuësit dhe shkaqet që ka parashtruar, ku pretendimet kryesore janë se ligji cenon parimin e sigurisë juridike, cenon të drejtën e pronës, cenon të drejtën e ankimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor; iii) analiza e çështjes, lidhur me 1) legjitimitimin e kërkuësit, 2) bazueshmërinë *prima facie* të pretendimeve, cenimin e të drejtës së pronës dhe të sigurisë juridike. Në përfundim të relacionit është parashtruar mendimi i këshilltarit për kalimin e

çështjes në seancë plenare. Relacioni në 11 faqe nuk përmban datë dhe nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Relacioni i tretë, që i përket kërkuesit Avokati i Popullit, është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë ligji që kërkohet të shfuqizohet, dekreti i Presidentit të Republikës lidhur me këtë ligj dhe vendimi i Kuvendit të Shqipërisë lidhur me këtë dekret; ii) pretendimet e kërkuesit dhe shkakun që ka parashtruar, ku pretendimet kryesore janë se ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi i ka dhënë ligjit fuqi prapavepruese dhe kufizon të drejtën e pronës; iii) analiza e çështjes, lidhur me 1) legjitimitimin e kërkuesit, 2) bazueshmërinë *prima facie* të pretendimeve, cenimin e të drejtës së pronës, të sigurisë juridike, të procesit të rregullt ligjor dhe pezullimit të zbatimit të ligjit. Në përfundim të relacionit është parashtruar mendimi i këshilltarit për kalimin e çështjes në seancë plenare dhe pranimin e kërkesës për pezullimin e ligjit objekt kërkesë. Relacioni në 10 faqe nuk përmban datë dhe nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Relacioni i katërt, që i përket kërkuesit Partia Republikane Shqiptare, është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë Ligji që kërkohet të shfuqizohet dhe objekti i tij; ii) pretendimet e kërkuesit dhe shkaqet, ku pretendimet kryesore janë se ligji cenon të drejtën e pronës, parimin e sigurisë juridike, krijon situatë pabarazie midis pronarëve, cenon të drejtën e ankimit në gjykatë, sjell pasoja të pariparueshme për të drejtën e pronës së subjekteve që preken nga ligji; iii) analiza e çështjes, lidhur me 1) legjitimitimin e kërkuesit, 2) bazueshmërinë *prima facie* të pretendimeve, cenimin e të drejtës së pronës, të sigurisë juridike dhe pezullimit të zbatimit të ligjit. Në përfundim të relacionit është parashtruar mendimi i këshilltarit për kalimin e çështjes në seancë plenare dhe pranimin e kërkesës për pezullimin e ligjit objekt kërkesë. Relacioni në 7 faqe, nuk përmban datë dhe nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Po kështu, ky subjekt ka paraqitur bashkëngjitur relacioneve edhe “Mendim mbi bazueshmërinë e kërkesave për shfuqizimin e ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, i cili është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë ligji që kërkohet të shfuqizohet, dekreti i Presidentit të Republikës lidhur me këtë ligj dhe vendimi i Kuvendit të Shqipërisë lidhur me dekretin; ii) pretendimet e kërkuesve dhe shkaqet, që fokusohen tek pretendimet se ligji cenon parimet e sigurisë juridike, të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, cenon të drejtën e pronës, cenon të drejtën e ankimit, si dhe nuk parashikon kompesim financiar të drejtë. Pasi ka parashtruar edhe njëherë pretendimet për secilin nga kërkuesit, vijohet me pjesën e tretë; iii) analiza e çështjes, lidhur me 1) legjitimitimin e kërkuesve, 2) bazueshmërinë në themel të pretendimeve, për cenim të sigurisë juridike, për cenim të barazisë para ligjit dhe për cenim të së drejtës së ankimit. Në përfundim, është parashtruar mendimi i këshilltarit për pranimin e kërkesave të kërkuesve, pasi ligji bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës, sepse nuk respekton parimin e sigurisë juridike dhe atë të barazisë së shtetasve para ligjit. Mendimi në 32 faqe i subjektit mban datën 25.05.2016 dhe është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Nga vendimi nr. 1, datë 21.04.2016 i Gjykatës Kushtetuese (shpallur me 16.01.2017) që i përket çështjes objekt relatiimi të subjektit, rezulton se **Gjykata ka vendosur pjesërisht sipas mendimit të subjektit Arta Vorpsi**, duke shpallur :

*“Pranimin e pjesërisht të kërkesës.*

*Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5 të Ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”.*

*Refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6, pika 1, shkronja “b” si dhe nenit 7, pika 2, shkronja “a” dhe “b” të ligjit të mësipërm.*

*Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër”.*

Paragrafët, si në katër relacionet ashtu edhe në mendim, janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të relacioneve nuk është përdorur ndonjë referencë në fund të faqeve, por në përmbajtje të mendimit janë përdorur referenca në faqet 3, 4, 8, 9, 12, 15, 17, 18, 22 e 23 të tij.

dh) Dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit në pikën 6 të rubrikës C të formularit, ka deklaruar se është autore e 6 librave dhe 24 artikujve juridikë, duke bashkëngjitur kopje të faqeve të para të shtatë botimeve me temë:

- Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë;
- Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese
- The europeanization of Albanian Constitutional Law;
- Recent developments in Albanian Constitutional Law;
- Democracy and constitutionalism – still a tense relationship in neë democracies: Some reflections on constitutional reforms in Albania;
- Roli i OJF-ve në forcimin e të drejtave dhe lirive themelore e interesave kolektive përmes gjykimit gjyqësor e atij kushtetues;
- Konstitucionalizmi i të drejtës private dhe qasja e gjykatave shqiptare.

Subjekti ka paraqitur vërtetimin me nr. (\*\*\*) prot, datë 24.10.2016 të lëshuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, sipas të cilës zonja Arta Vorpsi ka qenë trajnere në trajnimin me temë “Prezantim me administratën publike”. Po kështu ka paraqitur një *curriculum vitae* të saj dhe fotokopje të kartës të ID, ku konstatohet se të dhënat përputhen me ato të deklaruara prej saj në Formular.

**Në lidhje me 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short:**

1. **Dokumenti 1.** Opinion i subjektit Arta Vorpsi i datës 13.10.2014, për shqyrtimin paraprak në Kolegj të çështjes me kërkuar: R. T., subjekt të interesuar: Prokuroria e Përgjithshme, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vendimeve nr. 821, datë 19.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 61, datë 25.01.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 50, datë 16.01.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”

Opinionin është i strukturuar në 3 pjesë nga i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin penal të kërkuar, dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë për lënien në fuqi të dënimit, si dhe dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit; ii) pretendimet - parashtruar Gjykatës Kushtetuese, ku strukturohen në paragrafë të numërtuar nga 1-4 pretendimet e kërkuar për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, pasi: nuk është respektuar parimi i barazisë së palëve në gjykim,



arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kontradiktor dhe jo logjik, nuk është respektuar e drejta për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë, si dhe nuk është zbatuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese me nr. 47, datë 26.07.2012 për mosdhënien e dy dënimeve penale; III) analiza mbi bazueshmërinë e kërkesës, që fillon me paragrafë të numërtuar nga 1-4 dhe ku analizohet secili nga pretendimet e parashtruara, bazueshmëria e tyre në ligj dhe në jurisprudencë. Është analizuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte shqyrtuar në seancë rekursin e kërkuarit, pasi ai përmbante shkaqe që lidheshin me shkelje konkrete të rregullave procedurale penale. Kërkuari është dënuar nga gjykatat e ulëta me 6 muaj burgim dhe 200 mijë lekë gjobë. Vendimi i Gjykatës së Apelit mban datën 25.01.2012, ndërsa vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 26.07.2012. Rekursi është ushtruar në datën 22.02.2012 dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mban datën 16.01.2014, kohë në të cilën Gjykata Kushtetuese kishte shfuqizuar dispozitat penale mbi bazën e të cilave ishte dënuar kërkuari. Është analizuar gjithashtu se pavarësisht faktit që kërkuari nuk e ka parashtruar në recurs, pasi nuk mund të ishte në dijeni të vendimit që do të shpallte Gjykata Kushtetuese, Kolegji Penal *ex officio* duhet të kishte konstatuar antikushtetueshmërinë e vendimit të gjykatave më të ulëta, pasi çështja ishte ende në gjykim dhe si rregull duhet të zbatohet ligji i ri, i cili ishte më favorizues për të gjykuarin. Në paragrafin e fundit, lidhur me sa më sipër subjekti ka shfaqur mendimin se duhet shqyrtuar vetëm pretendimi për arsyetimin e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta, jo në përputhje me kriteret e vendosura, si dhe që Kolegji Penal nuk ka zbatuar vendimin nr. 47/2012 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shfuqizimin e dispozitave penale mbi të cilat është dënuar kërkuari.

Nga pikëpamja formale, opinionin është strukturuar me paragrafë në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar e me kryeradhë. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Gjithashtu, fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opinioni është i formatuar, ka datë hartimi dhe përmban 7 faqe. Ky akt është i panëshkruar.

Në opinionin janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të janë përdorur referenca në Kushtetutë, në ligjin organik për Gjykatën Kushtetuese, si dhe është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate. Kërkuari ka marrë përgjigje për pretendimet e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 12, datë 19.03.2015 ka vendosur :

*“Pranimin e kërkesës.*

*Shfuqizimin e vendimit nr. 50, datë 16.01.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), për pjesën në ngarkim të kërkuarit R. T.*

*Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë”.*

Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe i njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

2. **Dokumenti 2.** Opinionin i subjektit Arta Vorpsi, datë s'ka për shqyrtimin paraprak në Kolegjin të çështjes me kërkuar: E. P., subjekt i interesuar: E. R., me objekt: “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 8, datë 05.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi” .

Opiniononi është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi me paragrafë të numërtuar nga 1-3; ii) pretendimet-parashtruar Gjykatës Kushtetuese, ku strukturohen në paragrafë të numërtuar nga 1-4 pretendimet e palës kërkuese për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, se: nuk është shpallur brenda afatit ligjor, vjen në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë, është kontradiktor dhe se nuk janë këqyrur provat filmike të paraqitura; iii) analiza e çështjes, që fillon me paragrafë të numërtuar nga 5-21 dhe ku analizohet se: kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f e 134/1/g të Kushtetutës, legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 30/2 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Është vazhduar analiza me legjitimitetin *ratione materiae*, ku këshilltarja ka dhënë mendimin se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë është arsyetuar jashtë afateve ligjore, subjekti ka konkluduar se është i pabazuar, duke analizuar se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues kundër vendimit të Gjykatës së Lartë brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji për Gjykatën Kushtetuese. Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jologjik, subjekti ka konkluduar se është i pabazuar, duke analizuar se interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, përse kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor. Për pretendimin e moskëqyrjes së provave filmike si cenim i të drejtës së mbrojtjes, subjekti ka konkluduar se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar, duke analizuar se Gjykata e Lartë rrëzimin e kërtimeve për marrjen e atyre provave e ka bazuar në dispozitat procedurale penale, duke dhënë argumentat e saj në këtë drejtim. Në paragrafin 21 lidhur me sa më sipër, subjekti ka shfaqur mendimin se kërkesa është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

Nga pikëpamja formale, opiniononi është strukturuar me paragrafë në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar e me kryeradhë. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Gjithashtu, fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opiniononi është i formatuar, por nuk ka datë hartimi dhe përbëhet nga 9 faqe. Ky akt është i panënshkruar.

Në opinion janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të është përdorur referenca në Kushtetutë, ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, si dhe është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate. Kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimet e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 42, datë 12.07.2016 ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës*”. Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe i njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

3. **Dokumenti 3.** Opinion i subjektit A. V. datë 30.07.2015, për shqyrtimin paraprak në Kolegj të çështjes të kërkuetit: K. D., subjekte të interesuara: Zyra Qëndrore e RPP, Zyra Vendore e RPP Tiranë, Shoqëria Përmbarrimore “(\*\*\*)” sh.p.k Tiranë, me objekt: “Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Opiniononi është i strukturuar në 4 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi, me paragrafë të nisur me kryeradhë; ii) pretendimet-parashtruar Gjykatës Kushtetuese, ku strukturohet në një paragraf pretendimi i palës kërkuese për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës; iii) mbi kalimin e kërkesës për gjykim, ku analizohet se kërkesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 30/2 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Është vazhduar analiza me legjitimitetin *ratione materiae*, ku këshilltarja ka dhënë mendimin se kërkesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe Gjykata Kushtetuese është kompetente të shqyrtojë çështjen. *Bazueshmëria prima facia e pretendimeve*, analizohet nga subjekti si pasojë e refuzimit për të bërë regjistrimin e pronës. iv) Mbi pranimin e kërkesës në themel, ku këshilltarja ka parashtruar mendimin e saj për pranimin e kërkesës, duke analizuar si shkak refuzimin haptazi të palës debitore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në paragrafin e fundit, këshilltarja përfundimisht ka paraqitur mendimin se pretendimi i kërkueses është i bazuar dhe duhet pranuar, duke analizuar se mosekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, ka ardhur si rrjedhojë e mosveprimeve të palës debitore e për rrjedhojë ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Nga pikëpamja formale, opiniononi është strukturuar me paragrafë në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar e me kryeradhë. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Gjithashtu fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opiniononi është i formatuar, ka datë hartimi dhe përbëhet nga 5 faqe. Ky akt është i panënshkruar.

Në opinion janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të është përdorur referenca në Kushtetutë, ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate dhe të GjEDNJ-së. Kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimin e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 1, datë 21.01.2016 ka vendosur :

*“Pranimin e kërkesës.*

*Konstatimin e cenimit të të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe i njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

**Dokumenti 4.** Opinion i subjektit Arta Vorpsi datë 15.04.2013, për shqyrtimin paraprak në Kolegj, të çështjes me kërkuës: E. H. etj., subjekte të interesuar: Zh. B., H. B., V. B. e Bashkia Pogradec, me objekt: “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 255, datë 10.02.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vendimit nr. 282, datë 09.10.2009 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit nr. 00-2012-2408, datë 15.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.

Opiniononi është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë dhe në paragrafë të ndarë mosmarrëveshja objekt gjykimi: “Dispozitivi i vendimit të gjykatës së Rrethit gjyqësor Korçë për pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të KKKP-së Pogradec dhe njohjen e pronësisë për trashëgimtarët e N.S, dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë për lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë për lënien në fuqi të vendimit të apelit, dispozitivi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit; II) pretendimet-parashtruar Gjykatës Kushtetuese, ku strukturohen në paragrafë të evidentuar pretendimet e kërkuarit për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, se: gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar, megjithëse vlera e padisë ishte mbi 3 milion lekë; gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh urdhërimet e Gjykatës Kushtetuese; Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka dhënë vendim përfundimtar për zgjidhjen e çështjes; është shkelur siguria juridike pasi gjendja e bashkëpronësisë është prishur me vendime gjyqësore; dhe është shkelur parimi i paanshmërisë nga gjykata e apelit, duke dhënë një vendim shumë të shpejtë pas prishjes nga Gjykata Kushtetuese; iii) Mbi kalimin e kërkesës për gjykim, ku analizohet nga këshilltarja se kërkesa nuk përmban shkaqe të tilla që ta kenë bërë procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Janë analizuar me radhë të gjitha pretendimet e kërkuarës, duke arritur në konkluzionin se nuk duhet kaluar kërkesa në seancë, për shkak të mosekzistencës së shkaqeve.

Nga pikëpamja formale, opiniononi është strukturuar me paragrafë në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar e me kryeradhë. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Gjithashtu, fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opiniononi është i formatuar, ka datë të hartimit të tij dhe përbëhet nga 2 faqe. Ky akt është i panënshkruar.

Në opinion janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të janë nuk janë përdorur referenca. Kërkuarësi ka marrë përgjigje për pretendimet e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 49, datë 21.11.2013 ka vendosur: “*Refuzimin e kërkesës*”.

Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, por megjithëse nuk është i njëjtë me formën e zgjidhjes që ka dhënë kjo gjykatë nëpërmjet shqyrtimit në seancë plenare, konkluzioni ka qenë i njëjtë për mungesën e shkaqeve të një procesi të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Rrjedhimisht, konkludohet se mendimi i këshilltares ka lehtësuar dhënien e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

**Dokumenti 5.** Opinion i subjektit Arta Vorpsi, datë s’ka, për shqyrtimin paraprak në Kolegj të çështjes me kërkuar: A. H., me objekt: “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-2820, datë 05.03.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.

Opiniononi është i strukturuar në 3 pjesë: i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi me paragrafë filluar me kryeradhë dhe numërtuar nga 1-3, ku janë parastruar dispozitivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dispozitivi i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë; ii) pretendimet-parashtruar Gjykatës

Kushtetuese, ku strukturohen në paragrafë pretendimet e palës kërkuese për shfuqizimin e vendimit objekt kërkese numërtuar nga 4.1-4.3; iii) analiza e çështjes, që fillon me paragrafët numërtuar nga 5-6, ku analizohen: A) *legjitimiteti i kërkuesit* në bazë të nenit 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis* lidhur me paraqitjen e kërkesës brenda afatit 2-vjeçar dhe legjitimitimin *ratione materiale*, ku është analizuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave; B) *Për pretendimet e kërkuesit*, që fillon me paragrafët numërtuar nga 7-15, ku analizohet se Gjykata Kushtetuese ndërhyr në veprimet e gjykatave të zakonshme, vetëm kur cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor; analizohen pretendimet për mënyrën e vlerësimit të provave, se ato janë çështje që i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor; se dhënia apo jo e një mase më të lehtë dënimi është në vlerësim të gjykatave të faktit dhe nuk përbën shkak për shqyrtimin e rekursit në seancë; se vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi dhe mospranimi i tij, nuk mund të mjaftojë për të konkluduar se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë jo i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Përfundimisht në paragrafin e 15, këshilltarja ka arritur dhe ka parashtruar konkluzionin se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk ngre dyshime për cenim të elementeve të procesit të rregullt ligjor, prandaj të mos kalojë çështja në seancë plenare.

Nga pikëpamja formale, opinionioni është strukturuar me paragrafë në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar e me kryeradhë. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Gjithashtu fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opinionioni është i formatuar, por nuk ka datë hartimi. Ky akt përbëhet nga 4 faqe dhe është i panëshkruar.

Në opinion janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të janë përdorur referenca në Kushtetutë, ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, si dhe është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate. Kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimet e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin paraprak të kërkesës, me vendimin nr. 98, datë 17.05.2016 ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”*.

Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe i njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

Për subjektin e rivlerësimit Arta Vorpsi nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ajo ka ushtruar në këtë periudhë.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumentave ligjorë të vëzhguara të përzgjedhura me short.

## 1. Aftësitë profesionale

### a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën kushtetuese, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Njohuritë e saj ligjore konfirmohen edhe nga angazhimet e saj akademike ndër vite.

8 dokumentet ligjore konfirmojnë njohuritë e saj mbi garancitë procedurale në procesin gjyqësor, mbi të drejtën për të patur një vendim gjyqësor të arsyetuar, mbi masën e kompesimit për ish-pronarët, sipas kërkesave të proporcionalitetit, mbi cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, mbi barazinë e armëve dhe të drejtën e mbrojtjes në një proces gjyqësor, si dhe mbi juridiksionin jokushtetues të zgjidhjes së një mosmarrëveshje juridike për çështje fakti. Në 8 dokumentet ligjore të vëzhguar është konstatuar se është pasqyruar saktë dhe në mënyrë të detajuar mendimi i këshilltarit ligjor i argumentuar lidhur me ligjin e zbatueshëm material dhe procedural, si dhe propozimi për zgjidhjen konkrete të çështjes.

Karakteristikë e opinioneve të hartuara prej këshilltares ligjore Arta Vorpsi është pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, si dhe analiza e çështjes në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga kërkuesi, të cilat analizohen në frymën e gjykimit në nivel kushtetues prej subjektit, bazuar në normat kushtetuese, ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe praktikën e kësaj gjykate, protokollit të KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së. Në disa raste ka referuar në doktrinën kushtetuese gjermane apo praktikën e Gjykatës Kushtetuese Gjermane. Në dokumentet ligjore evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë të së drejtës, analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e raportuara.

Vlen të evidentohet se nga tri dokumentet ligjore të paraqitura prej saj, njeri prej tyre është jashtë periudhës së rivlerësimit.

### b) Arsyetimi ligjor

3 dokumentat ligjorë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi janë të shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirëorganizuar, duke u evidentuar edhe mendimi i subjektit për pretendimet e ngritura. Gjithashtu edhe 5 opinionet e vëzhguara, të përzgjedhura me short, në tërësinë e tyre janë të shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirëorganizuar, duke u evidentuar edhe mendimi i subjektit për pretendimet e ngritura. Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi respekton rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Fjalitë janë të qarta dhe me gjuhë profesionale. Opinionet janë të formatuar rregullisht, por jo gjithmonë shënohet data e tyre.

Nga pikëpamja e strukturës, opinionet ndahen në pjesë të veçanta, që tregojnë rrethanat e çështjes, pretendimet e kërkuesit dhe analizën ligjore të këshilltares. Ajo përdor rregullisht dhe saktë referencat kushtetuese, ligjore dhe në jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese. Në ndonjë rast, ajo përdor edhe metodën e analizës krahasimore me legjislacionet e huaja. Në opinionet e hartuara prej saj konstatohet se analiza ligjore i jep përgjigje pretendimeve të

identifikuara nga vetë këshilltarja nga kërkuesi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Në një rast, është konstatuar se ajo ka identifikuar edhe çështje, të cilave Gjykata Kushtetuese duhet t'i japë përgjigje *ex officio*, ndonëse çështja nuk është identifikuar nga kërkuesi në kërkesën e tij. Rrjedhimisht, konkludohet se aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit janë gjithëpërfshirëse dhe analiza ligjore paraqitet e argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të janë përdorur referenca në Kushtetutë, ligjin organik për Gjykatën Kushtetuese, si dhe është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate. Kërkuesi ka marrë përgjigje për pretendimet e identifikuara nga subjekti i rivlerësimit në opinionin e paraqitur.

Në 7 raste, mendimi paraqitet në formën e konkluzionit dhe përkon me zgjidhjen e dhënë nga Kolegji apo Gjykata Kushtetuese. Në 2 raste të tjera, mendimi përmban parashtrim të problematikave ligjore, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga Kolegji apo Gjykata Kushtetuese, që kanë lehtësuar vendimmarrjen mbi çështjen përkatëse. Vetë subjekti i rivlerësimit duket që përdor pothuajse të njëjtën strukturë në hartimin e opinioneve ligjore.

## **2. Aftësitë organizative**

### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka ushtruar detyrën e këshilltares në Gjykatën Kushtetuese. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar dhe ka përfunduar 33 çështje në vitin 2014; 32 çështje në vitin 2015 dhe 38 çështje në vitin 2016. Ajo ka deklaruar se nuk ka mbartur asnjë çështje nga viti 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 100 %. Ajo ka deklaruar se këto të dhëna i referohen çështjeve të caktuara për gjyqtarin relator, pranë të cilit ka punuar si këshilltare gjatë kësaj periudhe, pasi këshilltari ligjor ushtron veprimtari ndihmëse dhe nuk ka funksion vendimmarrës. Këto të dhëna statistikore janë të deklaruara nga vetë subjekti dhe nuk janë verifikuar nga Inspektorati.

Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Kushtetuese, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentat ligjorë, rezulton se këshilltarja ligjore Arta Vorpsi ka hartuar akte opinione për 95 çështje me natyrë kushtetuese.

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej vetë subjektit, evidentohet koha e kryerjes së detyrës nga këshilltarja, e cila është 7 ditë para seancës plenare dhe 6 muaj para seancës plenare. Në dokumentin e tretë nuk mund të përcaktohet koha e kryerjes së tij, pasi ai nuk përmban datë të shënuar. Gjithashtu edhe nga 3 prej 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short, si dhe nga vendimet përkatëse të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, të printuara nga faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese, evidentohet koha e kryerjes së detyrave prej këshilltares Arta Vorpsi, e cila është nga 5-6 muaj para seancës plenare mbi bazë dokumentash. Ndërsa në 2 raste: njëra në “seancë plenare mbi bazë dokumentesh” dhe tjetra në “shqyrtim paraprak të Kolegjit”, nuk evidentohet koha e kryerjes së detyrës nga subjekti.

Duke iu referuar nenit 6/1 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”, për sa i përket aspektit kohor, këshilltari ligjor i gjyqtarit relator duhet të vërë në dispozicion të gjyqtarëve të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese materialin e përgatitur prej tij të paktën 2 ditë përpara seancës. Në analizën e këtyre të dhënave për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, duhet evidentuar edhe fakti se

kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për këshilltarin ligjor të Gjykatës së Kushtetuese në aspektin sasior. Nisur nga analiza mësipër arrihet në konkluzionin se nga këshilltarja ligjore është zbatuar afati kohor, duke përjashtuar vetëm dy rastet kur opinionet nuk përmbanin datën e relatimit të tyre.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga të gjitha praktikat e administruara ka dokumentim të veprimeve të kryera nga këshilltarja ligjore, që shfaqet në formën e opinionëve apo materialeve shtesë studimore. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast, nga këshilltarja ligjore është bërë pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet parashtruara para Gjykatës Kushtetuese, si dhe analiza e çështjes, në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga kërkuesi të cilat analizohen në frymën e gjykimit në nivel kushtetues prej subjektit, bazuar në normat kushtetuese, ligjin për Gjykatën Kushtetuese, praktikën e kësaj gjykate dhe të GjEDNj-së. Në disa raste ajo ka referuar në doktrinën kushtetuese italiane e gjermane. Në dokumentet ligjore evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë të së drejtës dhe analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuara. Këto veprime ajo i ka materializuar në opinionin ligjor, por nuk ka plotësuar gjithmonë elementët proceduralë, kohën e hartimit të aktit, siç kërkohet në nenet 6/1, 10/1, a, 12/1 dhe 27/2, 3, të Rregullores së brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”, pasi në 2 nga opinionet e shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre. Gjithashtu evidentohet se në 7 nga 8 dokumentat ligjorë të vëzhguar, mungon nënshkrimi i subjektit të rivlerësimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në 5 dokumentat e përzgjedhur me short, rezulton se mendimi i këshilltarit ligjor është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse në formën e opinionëve. Nga ana tjetër, duhet theksuar se në 3 dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe në 3 nga 5 opinionet e shortuara identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet kanë datën e hartimit, por në 2 nga opinionet e shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre. Gjithashtu 7 nga 8 opinionet, janë pa nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi, ka paraqitur kopje diplome se ka fituar gradën “Doktor” në pranë Universitetit të Vienës, Austri, Fakulteti i Drejtësisë, njësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë. Ajo ka ushtruar edhe aktivitet akademik, në detyrën e trajneres pranë Shkollës së Magjistraturës, në programin vazhdues për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike në periudhën 2004-2014. Që nga muaji shtator 2005 e aktualisht, subjekti Arta Vorpsi ushtron detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk ka të dhëna nga burimet arkivore mbi etikën e këshilltares ligjore Arta Vorpsi, pasi ajo nuk ka ushtruar ndonjëherë detyrën e gjyqtares në shkallë të parë apo të dytë.

b) Integriteti



Nga dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi dhe nga 5 dokumentat e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në një rast, është konstatuar se ajo ka analizuar pretendimet për proces të rregullt ligjor në gjykimin e zhvilluar midis një deputeti dhe kryeministrit, ku ka konkluduar se pretendimet e ngritura nga deputeti nuk qëndrojnë. Duhet evidentuar se analiza ligjore e saj përkon me zgjidhjen që ka dhënë Gjykata Kushtetuese në vendimin përfundimtar.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 opinionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Arta Vorpsi. Në një rast, ajo ka identifikuar dhe ka analizuar parimin e gjykatës së paanshme në procesin gjyqësor civil, si aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në një rast, ajo ka identifikuar dhe ka analizuar parimin e barazisë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit në çështje që lidhen me të drejtat e pronësisë për subjektet e shpronësuara gjatë regjimit komunist. Në 6 dokumentet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të tjera që lidhen me grupet në nevojë, barazinë gjinore apo pakicat. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjeve e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dokumentat e vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) Aftësitë e komunikimit

Në të 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Arta Vorpsi me palët ndërgjyqëse pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë në asnjë prej opinionëve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese pranë të cilit ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore apo me trupën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes në seancën e shqyrtimit paraprak apo seancën plenare, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e këshilltarit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi ka deklaruar se tre vitet e fundit ka punuar në detyrën e këshilltares pranë Gjykatës Kushtetuese, detyrë e cila konsiston në veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin e vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë në shqyrtim pranë Gjykatës Kushtetuese, hartimin e projektvendimeve përfundimtare, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga gjyqtari relator, Kryetari ose Mbledhja e Gjyqtarëve. Gjithashtu gjatë tre viteve të fundit, subjekti i rivlerësimit ka qenë e angazhuar në aktivitet akademik, si trajnere pranë Shkollës së Magjistraturës dhe në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Ajo fituar doktoraturën në të drejtën kushtetuese dhe të drejtat kushtetuese. Subjekti i rivlerësimit Arta Vorpsi deklaroi se nuk është subjekt që trajnohet nga Shkolla e Magjistraturës, por megjithatë ajo ka qenë trajnere pranë Shkollës së Magjistraturës, në programin vazhdues për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në seminarin me temë “Zbatueshmëria e parimit kushtetues të së drejtës për të mos u gjykuar dy herë në këndvështrimin e KEDNJ-së”, të zhvilluar në datat 15-16 qershor 2016. Subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar gjithashtu se është autore e 6 librave dhe 24 artikujve juridikë.

Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar se gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, ka marrë pjesë në 8 trajnime dhe aktivitete ndërkombëtare, çka lidhet me thellimin e njohurive të saj në fushën e të drejtës kushtetuese dhe të drejtën civile. Por konstatohet se periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit, i përkasin vetëm 4 prej tyre, konkretisht në datat 17-18 tetor 2014; 9-10 mars 2015; 16-17 tetor 2015 dhe 14-15 tetor 2016, me gjithsej 8 ditë trajnim.

Bazuar në pikën 2 të nenit 42 të ligjit 84/2016, si burim për rivlerësimin profesional, përveç relacioneve dhe mendimeve ligjore të përgatitura nga kjo këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, shërbejnë edhe rezultatet e testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në testimin e kryer nga kjo Shkollë në datat 7-8 maj 2018. Bazuar në shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 23.05.2018 të Shkollës së Magjistraturës konstatohet se subjekti, në fazën e dytë të këtij testi, pjesë e vlerësimit profesional, ka arritur të marrë 145 pikë nga 200 në total.

Pranë Komisionit nuk ka asnjë denoncim për këtë subjekt.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Arta Vorpsi, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi shumë të mira në punë, arsyetim të drejtë, identifikon dhe analizon drejt problemet. Në disa raste mendimi i saj si këshilltare ligjore ka ndihmuar gjykatën në marrjen e vendimit. Ajo njeh shumë mirë parimet e së drejtës, si dhe respekton në arsyetim të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive. Subjekti ka aktivitet akademik për t’u konsideruar. Ajo është autore librash dhe artikujsh juridikë brenda fushës së aktivitetit të saj si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese.

#### **D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat

e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Vorpsi.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 12.11.2018.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**LULZIM HAMITAJ**

**Kryesues**

**VALBONA SANXHAKTARI**

**Anëtare**

**GENTA TAFA (BUNGO)**

**Relatore**

**Sekretare gjyqësore**

**DENISA KOSTA**